

PHILIPS

AVENT

SCF870



Manuali i përdorimit

Përmbajtja

E rëndësishme	3
Hyrje.....	7
Përshkrim i përgjithshëm	8
Për t'u pasur parasysh.....	9
Përpara përdorimit të parë.....	10
Përdorimi i pajisjes	10
Mbushja e depozitës së ujit.....	11
Gatimi me avull.....	11
Përzierja pas avullimit	14
Përzierja pa avull	16
Përbërësit dhe kohët e avullimit.....	19
Pastrimi dhe mirëmbajtja	20
Zhgëlqerëzimi i depozitës së ujit.....	21
Riciklimi.....	22
Vendruajtja	22
Mbështetja	23
Specifikimet teknike	23
Zgjidhja e problemeve	23

E rëndësishme

Lexojeni me kujdes këtë manual përdorimi përpara se ta vini në punë pajisjen, si dhe ruajeni për referencë në të ardhmen.

Rrezik

- Mos e zhytni kurrë njësinë motorike në ujë apo në ndonjë lëng tjetër, as mos e shpëlani në rubinet.

Paralajmërim

- Përpara se ta vini në punë pajisjen kontrolloni nëse tensioni i treguar në pajisje përkon me tensionin e rrjetit elektrik lokal.
- Mos e përdorni pajisjen nëse spina, kordoni elektrik ose vetë pajisja është e dëmtuar.
- Nëse kordoni elektrik është i dëmtuar, ai duhet ndërruar nga "Philips", nga një pikë servisi e autorizuar nga "Philips" ose nga persona me kualifikim të ngjashëm, në mënyrë që të shmangni rreziqet.
- Kjo pajisje mund të përdoret nga fëmijë me aftësi të reduktuara fizike, shqisore apo mendore, apo që kanë mungesë përvoja dhe njohurish vetëm nëse u kushtohet mbikëqyrja e duhur apo u jepen udhëzime në lidhje me përdorimin e sigurt të pajisjes, si dhe nëse kuptojnë rreziqet e përfshira.
- Kjo pajisje nuk duhet përdorur nga fëmijët. Mbajeni pajisjen dhe kordonin larg vendeve ku mund të arrihet nga fëmijët.
- Fëmijët nuk duhet të luajnë me pajisjen.
- Mos i prekni tehet e helikës kur pajisja është në prizë dhe gjatë pastrimit. Tehet prerëse janë shumë të mprehta.
- Nëse helika ngec, hiqeni pajisjen nga priza përpara se të hiqni përbërësit që bllokojnë helikën.
- Pajisja nxehet shumë gjatë avullimit dhe mund të shkaktojë djegie nëse e prekni. Ngrijeni kanën vetëm duke e kapur nga doreza.
- Kujdes nga avulli i nxehtë që del nga kana gjatë avullimit dhe kur i hiqni kapakun.

- Kujdes nga avulli i nxehtë që del nga ana e mbushjes së depozitës së ujit kur i hapni kapakun.
- Kur të përfundojë procesi i avullimit, avulli i nxehtë vazhdon të dalë nga dalja e avullit në njësinë motorike dhe vrima e avullit në kapakun e kanës për ca kohë. Bëni kujdes kur hiqni kanën nga njësia motorike.
- Nëse pajisja përdoret në mënyrë jo të duhur, avulli i nxehtë mund të dalë nga ana e mbushjes. Shihni kapitullin "Diagnostikimi" për ta shmangur apo zgjidhur këtë.
- Kurrë mos e lini pajisjen në punë pa mbikëqyrje.
- Mos e çmontoni njësine motorike për qëllime mirëmbajtjeje ose pastrimi. Dërgojeni për riparim te një pikë servisi e autorizuar nga "Philips".

Kujdes

- Mos përdorni kurrë aksesore apo pjesë nga prodhues të tjerë apo që nuk rekomandohen specifikisht nga "Philips". Nëse përdorni aksesore apo pjesë të tilla, garancia juaj bëhet e pavlefshme.
- Mos e vendosni pajisjen mbi apo pranë një sobe apo tenxhereje në punë apo ende të nxehtë.
- Hiqeni gjithnjë pajisjen nga priza dhe lëreni të ftohet përpara se ta pastroni.
- Asnjëherë mos e përdorni kanën ose ndonjë pjesë tjetër të pajisjes në mikrovalë, pasi pjesët metalike të dorezës së kanës dhe helikës nuk janë të përshtatshme për këtë përdorim.
- Asnjëherë mos e sterilizoni kanën ose ndonjë pjesë tjetër të pajisjes në sterilizues apo mikrovalë, pasi pjesët metalike të dorezës së kanës dhe helikës nuk janë të përshtatshme për këtë përdorim.
- Kjo pajisje synohet vetëm për përdorim shtëpiak. Nëse pajisja përdoret në mënyrë të papërshtatshme apo për qëllime profesionale ose gjysmë-profesionale apo nuk përdoret sipas udhëzimeve në këtë manual përdorimi, garancia bëhet e pavlefshme dhe "Philips" refuzon çdo lloj përgjegjësie për dëmin e shkaktuar.

- Bëni kujdes kur hidhni lëngje të nxehta në gotën e masave, pasi lëngjet e nxehta dhe avulli mund të dalin jashtë e të shkaktojnë djegie.
- Lëreni pajisjen të ftohet për 10 minuta para se të avulloni një grup tjetër përbërësish.
- Pajisja nuk është e destinuar për copëtimin e përbërësve të fortë si kubikë akulli dhe sheqeri.
- Mos e lini pajisjen të përziejë për më shumë se 30 sekonda për rast. Nëse nuk keni mbaruar përzierjen pas 30 sekondash, fiken pajisjen dhe prisni disa sekonda para se të vazhdoni. Nëse pajisja nxehtet, lëreni të ftohet për disa minuta para se të vazhdoni.
- Vëreni pajisjen mbi një sipërfaqe të qëndrueshme, horizontale dhe të rrafshët. Sigurohuni që të ketë hapësirë të mjaftueshme të lirë rreth saj për të parandaluar dëmtimin e p.sh. mobilieve apo objekteve të tjera, pasi pajisja lëshon avull të nxehtë gjatë përdorimit.
- Mos e përdorni pajisjen nëse është rrëzuar apo ka pësuar ndonjë dëmtim. Dërgojeni për riparim te një pikë servisi e autorizuar nga "Philips".
- Asnjëherë mos vendosni ujë, lëngje të tjera ose ushqim të përzier në kanë për avullim për të shmangur dëmtimin e pajisjes.
- Kur avulloni përbërësit, sigurohuni që të mos e tejmbushni kanën. Sigurohuni që buza e sipërme e njësisë së gjelbër të teheve të mos jetë e mbuluar me ushqim.
- Kur përzieni lëngje, mos e tejkaloni nivelin maksimal të treguar në kanë (450 ml).
- Mos futni asnjë objekt në anën e mbushjes ose daljen e avullit.
- Asnjëherë mos përdorni funksionin e avullimit pa ujë.
- Sigurohuni që të mos tejmbushni depozitën e ujit (maks. 200 ml). Mos e tejkaloni nivelin maksimal të përcaktuar në kupën e vogël.
- Asnjëherë mos e mbushni depozitën e ujit gjatë procesit të avullimit, pasi uji i nxehtë dhe avulli mund të dalin nga pajisja si rezultat.



- Gjithmonë sigurohuni që kapaku të jetë ftohur pas avullimit para se ta hapni për të shtuar më shumë përbërës për përzierje, nëse është e nevojshme.
- Mos e lidhni pajisjen me stakues të jashtëm, si p.sh. me kronometër, dhe mos e lidhni me qark që takohet dhe stakohet rregullisht nga shërbimi elektrik. Kjo parandalon një rrezik që mund të shkaktohet nga rivendosja e paqëllimshme stakimit termik.
- Kontrolloni gjithnjë temperaturën e ushqimit të foshnjës përpara se ta ushqeni foshnjën.
- Gjithmonë kontrolloni konsistencën e ushqimit të foshnjës. Sigurohuni që të mos ketë copëza në ushqim.
- Kur procesi i avullimit të përfundojë (maks. 20 minuta), mos avulloni apo ngrohni sërish ushqimin e foshnjës.
- Përdorni vetëm shpatullën e dhënë për të hequr ushqimin nga kana.
- Zhgëlqerëzimi i rregull parandalon dëmtimin e pajisjes.
- Fikni pajisjen dhe hiqeni atë nga priza përpara se të ndërroni aksesoret ose përpara se t'u afroheni pjesëve që lëvizin gjatë përdorimit.
- Bëni kujdes kur manovroni helikën e mprehtë, kur zbrazni kanën dhe gjatë pastrimit.
- Hiqeni gjithmonë pajisjen nga priza nëse mbetet pa mbikëqyrje.
- Pastrimi dhe mirëmbajtja nga përdoruesi nuk duhen kryer nga fëmijët.
- Niveli i zhurmës: $L_c = 89 \text{ dB(A)}$.

Sistemi i sigurisë

Pajisja është e pajisur me një siguresë të integruar. Pajisja funksionon vetëm nëse keni montuar siç duhet të gjitha pjesët në njësinë motorike. Nëse të gjitha pjesët janë mbledhur në mënyrë korrekte, siguresa e integruar do të shkyçet.

Pajisja është gjithashtu e pajisur me mbrojtje nga mbinxehja. Mbinxehja mund të ndodhë nëse koha midis dy proceseve të avullimit është shumë e shkurtër, nëse funksioni i përzierjes përdoret shumë gjatë ose nëse ka shumë përbërës në kanë. Nëse mbrojtja nga mbinxehja e fik pajisjen gjatë përdorimit, vendosni çelësin e kontrollit në 0 dhe lëreni pajisjen të ftohet për disa minuta. Pas kësaj, mund ta përdorni përsëri pajisjen.

Fushat elektromagnetike (EMF)

Kjo pajisje "Philips" pajtohet me të gjitha standardet dhe rregulloret në fuqi për ekspozimin ndaj fushave elektromagnetike.


Hyrje

Urime për blerjen dhe mirë se vini pranë Philips Avent! Për të përfituar plotësisht nga mbështetja që ofron "Philips Avent", regjistroni produktin në

www.philips.com/welcome.


Ky avullues dhe mikser i kombinuar është veçanërisht i përshtatshëm për përgatitjen e sasive të vogla të ushqimit për foshnja. Avulluesi dhe mikseri i kombinuar ju vjen në ndihmë të gjithë prindërve për përgatitjen e vakteve të freskëta për foshnjat e tyre me një funksion të thjeshtë avullimi dhe përzierjeje të kombinuar në një pajisje.

Përshkrim i përgjithshëm



1	Kapaku me vrimën e avullit	8	Njësia e motorit
2	Sita	9	Llamba e avullimit
3	Helika	10	Çelësi i kontrollit
4	Kana me mbajtësen e helikës	11	Valvula
5	Ana e mbushjes së depozitës të ujit	12	Shpatulla
6	Dalja e avullit në njësinë motorike	13	Kupa e matjes
7	Zona e kyçjes për dorezën	14	Fundi i pajisjes me kordonin elektrik


Për t'u pasur parasysh




- Kontrolloni temperaturën e ushqimit të foshnjës në shpinën e dorës para se të ushqeni foshnjën.




- Mos e tejkaloni nivelin maksimal të përcaktuar në kanë (450 ml).




- Përdorni 200 ml ujë të distiluar për të mbushur depozitën e ujit.




- Mos copëtoni përbërës të fortë, si p.sh. kuba akulli dhe sheqeri.




- Vendosni helikën në mbajtësen e saj në kanë përpara se të vendosni ushqim në kanë kur avulloni ose përzieni.



- Gjithmonë vendosni sitën në kapakun e kanës ("klik").



- Mos e lini pajisjen të përziejë për më shumë se 30 sekonda për rast.



- Pastroni çmërsin e pajisjes çdo 4 javë.

Përpara përdorimit të parë

- 1** Hiqni të gjithë materialin e paketimit nga pajisja.
- 2** Pastroni të gjitha pjesët përveç njësisë së motorit (shihni kapitullin "Pastrimi dhe mirëmbajtja").

Përdorimi i pajisjes

Gjithmonë sigurohuni që kapaku të jetë ftohur pas avullimit para se ta hiqni për të shtuar më shumë përbërës për përzierje, nëse është e nevojshme. Mos e tejkaloni nivelin maksimal të përcaktuar në kanë.

Zbrazni depozitën e ujit para se ta rimbushni për të filluar një proces të ri avullimi.

Gjithmonë sigurohuni që buza e sipërme e helikës së gjelbër të mos jetë e mbuluar me ushqim kur filloni të avulloni.


Kjo pajisje ka për qëllim avullimin e përbërësve të freskët të ngurtë dhe më pas përzierjen e tyre për të marrë ushqimin e foshnjës. Shihni broshurën e recetave për disa shembuj. Normalisht së pari do të avulloni përbërësit dhe më pas do t'i përziereni. Megjithatë, pajisjen mund ta përdorni edhe vetëm për avullim ose përzierje. Kur ta përdorni pajisjen vetëm për përzierjeje, anashkaloni seksionet "Mbushja e depozitës së ujit" dhe "Avullimi" dhe ndiqni vetëm udhëzimet në seksionin "Përzierja". Pas përzierjes, mos avulloni kurrë ushqim që është përzier përpara. Asnjëherë mos avulloni të njëjtin grup përbërësish për më shumë se 20 minuta ose më shumë se një herë.

Kjo pajisje NUK synohet për:

- Shkrirjen e ushqimit
- Avullimin e ushqimit të ngrirë
- Avullimin e ushqimit të përzier më parë
- Avullimi i përbërësve të njëjtë për më shumë se 20 minuta
- Gatimin e orizit dhe të makaronave
- Përzierjen e përbërësve përpara dhe pastaj avullimin e tyre
- Ngrohjen e lëngjeve, p.sh. supë ose ujë
- Mbajtjen e ushqimit të ngrohtë për disa orë
- Ringrohjen e ushqimit

Mbushja e depozitës së ujit

- 1 Mbushni gotën matëse me ujë deri në nivelin e kërkuar.



Gota matëse tregon mililitrat dhe kohën përkatëse të avullimit në minuta. Shihni broshurën e veçantë të recetave për sasitë e rekomanduara për recetat.

- 2 Hidhni ujin në vrimën e mbushjes dhe mbyllni kapakun.



Shënim: Asnjëherë mos vendosni gjë tjetër veç ujit në depozitën e ujit.


Gatimi me avull

Nëse disa perime dhe fruta avullohen lehtë, ato janë ideale për foshnjat që fillojnë të hanë ushqime të ngurta. Avullimi është mënyra më e shëndetshme e përgatitjes së ushqimit, pasi ky i fundit ruan shumë nga vitaminat dhe vlerat ushqyese.

Shënim: Recetat dhe kohët e gatimit të kërkuara për këto receta mund t'i gjeni në broshurën e veçantë të recetave. Kini parasysh se recetat janë përgatitur sipas moshës së fëmijës.

Shënim: Mos i avulloni përbërësit e ngrirë, pasi pajisja nuk mund të ngrohë ushqimin e ngrirë në temperaturën e kërkuar për avullim. Shkrijini gjithmonë përbërësit e ngurtë të ngrirë para se t'i avulloni në këtë pajisje. Shkundni ujin e mundshëm të tepërt nga përbërësit e shkrirë para se t'i vendosni në kanë.


- 1 Vendosni njësinë e teheve në mbajtësen e njësisë së teheve në kanë.



- 2** Pritini përbërësit e ngurtë në copa të vogla (kuba jo më të mëdhenj se 2-3 cm) përpara se t'i vendosni në kanë.

Shënim: Mos përpunoni një sasi të madhe përbërësish të ngurtë në të njëjtën kohë. Përpunojini më mirë këta përbërës në një sërë grupesh të vogla.


- 3** Vendosni përbërësit në kanë.



Shënim: Mos e tejkaloni buzën e sipërme të njësisë së gjelbër të teheve.


Shënim: Për të shmangur dëmtimin e pajisjes, mos vendosni asnjëherë ujë ose lëngje të tjera në kanë për avullim.

- 4** Vendosni valvulën në kapak.




Shënim: Sigurohuni që valvula të jetë fiksuar siç duhet.


- 5** Vendosni sitën në kapakun e kanës ("klik").



- 6** Vendosni kapakun në kanë dhe kthejeni në drejtimin orar për ta fiksuar. Pjesët e vogla të dala të kapakut duhet të rrëshqasin në kanalet e kanës. Sigurohuni që e dala e madhe e kapakut të vendoset saktësisht mbi dorezën e kanës.




- 7** Vendosni kanën përmbys në njësinë e motorit, d.m.th. me kapakun për poshtë. Sigurohuni që doreza të jetë në anën e djathtë dhe të jetë vendosur siç duhet.



Shënim: Pajisja nuk fillon të avullojë nëse kana dhe doreza nuk janë në pozicionin e duhur.

- 8** Kthejeni çelësin e komandimit në pozicionin e avullimit.

↳ Llama e avullimit do të ndizet në ngjyrë portokalli për të treguar që pajisja po avullon.




Avulli i nxehtë ose uji i nxehtë mund t'ju djegë gishtat. Mos i prekni dhe mos i lini kurrë fëmijët të prekin pjesët e nxehta dhe avullin, pasi kjo mund të shkaktojë djegie.



- ↳ Koha e avullimit varet nga sasia e ujit që keni hedhur në depozitën e ujit. Shihni tabelën në kapitullin "Përbërësit dhe koha e avullimit" dhe broshurën e recetave.
- ↳ Kur të përfundojë procesi i avullimit, pajisja prodhon një tingull gumëzhitës dhe llamba e avullimit fiket.

- 9** Vendoseni çelësin e komandimit në pozicionin fikur. Prisni 2 minuta derisa të mos dalë më avull nga dalja e avullit, për të shmangur djegien nga avulli i nxehtë.




Shënim: Nëse dëshironi të avulloni një grup tjetër përbërësish, lëreni pajisjen të ftohet për 10 minuta para se të filloni përsëri avullimin.

- 10** Nëse dëshironi të vazhdoni me përzierjen e ushqimit të avulluar, ndiqni udhëzimet në seksionin "Përzierja pas avullimit" më poshtë.
- 11** Në kushte normale, nuk mbetet fare ujë në depozitën e ujit pas avullimit. Megjithatë, në disa situata (p.sh. në rast akumulimi çmërsi brenda depozitës së ujit, ndërprerjeje të procesit të avullimit ose përdorimi të paqëllimshëm), në depozitën e ujit mund të mbetet pak ujë. Në këtë rast, zbrazeni plotësisht depozitën e ujit pas përdorimit për të shmangur rritjen e baktereve. Për të pastruar çmërsin në depozitën e ujit, shihni kapitullin "Pastrimi dhe mirëmbajtja".

Përzierja pas avullimit

- 1** Kapeni dorezën e kanës dhe hiqni kanën nga njësia motorike. Kthejeni kanën përmbyss dhe tundeni, në mënyrë që ushqimi të bjerë në njësinë e teheve.



Prekni vetëm dorezën e kanës. Kapaku, sipërfaqja e poshtme dhe e jashtme e kanës janë të nxehta.




- 2** Nëse është e nevojshme, hiqni kapakun dhe shtoni përbërës shtesë për përzierje (p.sh. ujë ose vaj).


Gjithmonë sigurohuni që pas avullimit, kapaku i kanës dhe kapaku i depozitës së ujit të jenë ftohur para se t'i hapni ato për të shtuar përbërës të tjerë në kanë ose për të hequr ujin e mbetur nga depozita e ujit.

Pasi të keni vendosur lëngje në kanë, asnjëherë mos e vendosni kanën në pozicionin e avullimit.

- 3** Vendosni kanën në pozicion vertikal lart në njësinë e motorit, d.m.th. me kapakun për lart. Sigurohuni që doreza të jetë në anën e djathtë dhe e pozicionuar ndërmjet dy skajeve në zonën e kyçjes.



- 4** Kthejeni çelësin e komandimit në pozicionin e përzierjes. Mbajeni çelësin në këtë pozicion derisa ushqimi të përzieret siç duhet.




Ka një kohëmatës 30-sekondësh për funksionin e përzierjes si mbrojtje nga mbinxehja. Nëse nuk keni mbaruar përzierjen pas 30 sekondash, pajisja do të fiket dhe do të lëshojë dy herë tingullin bip për të njoftuar. Pasi të ftohet për 30 sekonda, pajisja lëshon një tingull bip dhe mund të filloni të përzieni përsëri.

Shënim: Nëse përbërësit ngjiten në murin e kanës, fikeni pajisjen dhe lirojini me shpatull ose shtoni pak lëng.

Shënim: Sigurohuni që ushqimi i përzier për foshnjën të ketë konsistencën e duhur (p.sh. pa kokrriza) para se ta shërbeni.

Shënim: Nëse ushqimi i foshnjës është ende shumë i fortë, shtoni pak lëng (p.sh. ujë) derisa të jetë i butë.

- 5** Pasi të keni mbaruar përzierjen, thjesht lëshoni çelësin e komandimit.



↳ Çelësi kthehet automatikisht në pozicionin fikur.

- 6** Hiqeni pajisje nga priza.

- 7** Hiqeni njësinë e teheve. Bëni kujdes kur hiqni helikën pasi mund të jetë e nxehtë. Hiqni ushqimin e përzier nga kana. Nëse është e nevojshme, përdorni shpatullën e përfshirë me këtë pajisje.

Sigurohuni që ushqimi i foshnjës të ketë temperaturën e përshtatshme për të.

- 8** Në kushte normale, nuk mbetet fare ujë në depozitën e ujit pas avullimit. Megjithatë, në disa situata (p.sh. në rast akumulimi çmërsi brenda depozitës së ujit, ndërprerjeje të procesit të avullimit ose përdorimi të paqëllimshëm), në depozitën e ujit mund të mbetet pak ujë. Në këtë rast, zbrazeni plotësisht depozitën e ujit pas përdorimit për të shmangur rritjen e baktereve. Për të pastruar çmërsin në depozitën e ujit, shihni kapitullin "Pastrimi dhe mirëmbajtja".

Përzierja pa avull

Pajisja synohet për:

- përgatitja e puresë me përbërësit e avulluar dhe të gatuar për ushqim foshnjeje
- përzierja e lëngjeve dhe frutave për pijet e foshnjave


Pajisja nuk është e destinuar për copëtimin e përbërësve të fortë si kubikë akulli dhe sheqeri.

Pasi të keni vendosur lëngje në kanë, mos e vendosni asnjëherë kanën në pozicionin e avullimit.

Shënim: Kur përzieni përbërësit e lëngshëm, sigurohuni që të mos e mbushni kanën përtej nivelit maksimal të treguesit në kanë.

Shënim: Mos e avulloni asnjëherë ushqimin e foshnjës pasi ta keni përzier.


- 1** Vendosni njësinë e teheve në mbajtësen e njësisë së teheve në kanë.



- 2** Pritini përbërësit e ngurtë në copa të vogla (kuba jo më të mëdhenj se 2-3 cm) përpara se t'i vendosni në kanë.


Këshillë: Mos përpunoni një sasi të madhe përbërësish të ngurtë në të njëjtën kohë. Përpunojini më mirë këta përbërës në një sërë grupesh të vogla.

- 3** Vendosni përbërësit në kanë.




Shënim: Mos e tejkaloni buzën e sipërme të njësisë së gjelbër të teheve.

- 4** Vendosni valvulën në kapak.




Shënim: Sigurohuni që valvula të jetë fiksuar siç duhet.


- 5** Vendosni sitën në kapakun e kanës ("klik").




- 6** Vendosni kapakun në kanë dhe kthejeni në drejtimin orar për ta fiksuar. Pjesët e vogla të dala të kapakut duhet të rrëshqasin në kanalet e kanës. Sigurohuni që e dala e madhe e kapakut të vendoset saktësisht mbi dorezën e kanës.



- 7** Vendosni kanën në pozicion vertikal lart në njësinë e motorit, d.m.th. me kapakun për lart. Sigurohuni që doreza të jetë në anën e djathtë dhe e pozicionuar ndërmjet dy skajeve në zonën e kyçjes.



- 8** Kthejeni çelësin e komandimit në pozicionin e përzierjes. Mbajeni çelësin në këtë pozicion derisa ushqimi të përzihet siç duhet.



Ka një kohëmatës 30-sekondësh për funksionin e përzierjes si mbrojtje nga mbinxehja. Nëse nuk keni mbaruar përzierjen pas 30 sekondash, pajisja do të fiket dhe do të lëshojë dy herë tingullin bip për të njoftuar. Pasi të ftohet për 30 sekonda, pajisja lëshon një tingull bip dhe mund të filloni të përzieni përsëri.


Shënim: Nëse përbërësit ngjiten në murin e kanës, fikeni pajisjen dhe lirojini me shpatull ose shtoni pak lëng. Mos e tejkaloni nivelin maksimal të treguar në kanë.

Shënim: Sigurohuni që ushqimi i përzier për foshnjën të ketë konsistencën e duhur (p.sh. pa kokrriza) para se ta shërbeni.

Shënim: Nëse ushqimi i foshnjës është ende shumë i fortë, shtoni pak lëng (p.sh. ujë) derisa të jetë i butë. Mos e tejkaloni nivelin maksimal të treguar në kanë.

Shënim: Mos e avulloni asnjëherë ushqimin e foshnjës pasi ta keni përzier.

- 9** Pasi të keni mbaruar përzierjen, thjesht lëshoni çelësin e komandimit.



↳ Çelësi kthehet automatikisht në pozicionin e fikur.

- 10** Hiqeni pajisje nga priza.

- 11** Hiqeni njësinë e teheve. Bëni kujdes kur hiqni helikën pasi mund të jetë e nxehtë. Hiqni ushqimin e përzier nga kana. Nëse është e nevojshme, përdorni shpatullën e përfshirë me këtë pajisje.

Sigurohuni që ushqimi i foshnjës të ketë temperaturën e përshtatshme për të.

Përbërësit dhe kohët e avullimit

Lloji i ushqimit	Përbërësi	Koha e përafërt e avullimit*
Fruta	Mollë	5 min.
	Portokaj:	10 min.
	Pjeshkë	10 min.
	Dardhë	5 min.
	Ananas	15 min.
Perimet	Kumbull	10 min.
	Shpargull	10 min.
	Brokoli	20 min.
	Karotë	15 min.
	Lulelakër	15 min.
	Selino	15 min.
	Kungull i njomë	15 min.
	Finok	15 min.
	Bishtaja	20 min.
	Pras	15 min.
	Qepë	15 min.
	Bizele	20 min.
	Spec	15 min.
	Patate	20 min.
	Kungull	15 min.
	Spinaq	15 min.
	Rrepë	15 min.
	Patate e ëmbël	15 min.
	Domate	15 min.
Mish	Mish pule, viçi, qengji, derri etj.	20 min.
Peshk	Salmon, shojzë, merluc, troftë etj.	15 min.

* I gjithë ushqimi duhet të pritet në kuba të vegjël, jo më të mëdhenj se 2-3 cm.

Shënim: Gota matëse tregon mililitrat dhe kohën përkatëse të avullimit në minuta (50 ml = 5 min., 100 ml = 10 min., 150 ml = 15 min., 200 ml = 20 min.).

Pastrimi dhe mirëmbajtja


Pastrojeni pajisjen pas çdo përdorimi.

Mos e zhysni asnjëherë në ujë njësinë motorike.


Asnjëherë mos përdorni klor apo solucione/tableta sterilizuese kimike në pajisje.

Mos përdorni asnjëherë sfungjerë gërvishtës, solucione gërryese apo detergjentë të lëngshëm agresivë, si p.sh. benzinë, aceton apo alkool për të pastruar pajisjen.


1 Hiqeni pajisjen nga priza dhe hiqni kanën nga njësia e motorit.



2 Hiqeni kapakun nga kana dhe kthejeni kapakun përmbys.




3 Hiqeni sitën dhe valvulën nga kapaku.




4 Pastroni valvulën në ujë të nxehtë me pak lëng larës dhe shpëlajeni nën rubinet.

5 Hiqeni njësinë e teheve nga kana.



- 6** Pastrojeni helikën nën rubinet tërësisht, menjëherë pas përdorimit. Sigurohuni që të shpëlani edhe pjesën e brendshme të tubit të njësisë së teheve.



Mbajeni njësinë e teheve me shumë kujdes. Tehet prerëse janë shumë të mprehta.

Shënim: Nëse dëshironi ta pastroni helikën më hollësisht, mund ta vendosni edhe në enëlarëse pasi ta keni shpëlarë.

- 7** Pastroni pjesët e tjera që kanë rënë në kontakt me ushqimin në ujë të nxehtë me pak lëng larës menjëherë pas përdorimit.

Shënim: Të gjitha pjesët, përveç njësisë së motorit, mund të pastrohen edhe në enëlarëse.

- 8** Nëse është nevoja, pastrojeni njësinë motorike me një leckë të lagur.

- 9** Kontrolloni nëse ndonjë copëz ushqimi ka hyrë në depozitën e ujit. Këtë mund ta bëni duke shikuar vrimën e mbushjes për të parë nëse ka copëza ushqimi në të ose duke kontrolluar nëse uji ka ndonjë ngjyrë të pazakontë, si dhe duke nuhatur nëse depozita i ujit lëshon erë të pakëndshme ose të djegur.

Në këtë rast, pastroni depozitën e ujit (shih seksionin "Pastrimi i depozitës së ujit" në këtë kapitull).

- 10** Lini hapur kapakun e vrimës së mbushjes për të parandaluar rritjen e baktereve.

Zhgëlqerëzimi i depozitës së ujit

Nëse grimcat e ushqimit hyjnë në depozitën e ujit, ato mund të ngecin në rezistencën e depozitës së ujit gjatë proceseve të ardhshme të avullimit. Këto copëza nuk mund të hiqen thjesht me shpëlarjen e depozitës së ujit.

Përveç kësaj, duhet ta zhgëlqerëzoni pajisjen çdo katër javë për t'u siguruar që të vazhdojë të punojë me 100% efikasitet. Për të zvogëluar akumulimin e gëlqeres, është e dobishme të përdorni ujë të zier ose të filtruar paraprakisht në pajisje.

Për të hequr grimcat e ushqimit nga depozita e ujit dhe për të pastruar çmërsin nga pajisja, ndiqni udhëzimet e mëposhtme për pastrimin e çmërsit.

- 1** Sigurohuni që pajisja të jetë fikur.

- 2** Shtoni 50 ml uthull të bardhë (8% acid acetik) në 150 ml ujë.

Shënim: Mund të përdorni edhe pastrues çmërsi me bazë acidi citrik. Mos përdorni lloje të tjera zhgëlqerëzuesish.

- 3** Mbusheni depozitën e ujit me tretësirën e uthullës (ose acidit citrik) dhe ujit.

- 4** Mbyllni kapakun e vrimës së mbushjes.


- 5** Vendoseni kanën boshe (pa ushqim brenda) të montuar plotësisht me njësinë e teheve dhe kapakun në njësinë e motorit në pozicionin e avullimit (d.m.th. me kapakun të drejtuar për poshtë).

6 Kthejeni çelësin e komandimit në pozicionin e avullimit.

↳ Llama e avullimit do të ndizet në ngjyrë portokalli për të treguar që pajisja po avullon.

7 Fikeni gjithmonë pajisjen pas 5-6 min. avullimi dhe hiqeni nga priza.

8 Zbrazeni tretësirën e përdorur të uthullës (8% acid acetik) dhe ujit nga depozita e ujit.



9 Shpëlajeni mirë depozitën e ujit dhe kanën disa herë me ujë të freskët.

10 Mbushni depozitën e ujit me 200 ml ujë dhe lëreni pajisjen të përfundojë një proces avullimi 20-minutësh me kanën bosh para se ta përdorni përsëri pajisjen me ushqim.

11 Lini hapur kapakun e vrimës së mbushjes për të parandaluar rritjen e baktereve.


Riciklimi

- Ky simbol do të thotë që produktet elektrike nuk duhet të hidhen me mbeturinat e zakonshme të shtëpisë.
- Zbatoni rregulloret e shtetit tuaj për grumbullimin e veçuar të produkteve elektrike.



Vendruajtja

1 Zbrazni depozitën e ujit para se ta ruani pajisjen.



2 Sigurohuni që të gjitha pjesët të jenë të pastra dhe të thata përpara se ta ruani pajisjen (shihni kapitullin "Pastrimi dhe mirëmbajtja").

3 Ruajeni pajisjen me njësinë e teheve në kanë për të parandaluar dëmtimin.

4 Mos e vendosni kapakun në kanë dhe mos lini hapur kapakun e vrimës së mbushjes për të shmangur rritjen e baktereve.

Mbështetja

Për mbështetje për të gjitha produktet, si pyetjet më të shpeshta, vizitoni www.philips.com/support.

Specifikimet teknike

- Tensioni/fuqia: shihni pllakën e llojit në pjesën e poshtme të pajisjes.
- Kapaciteti maksimal i depozitës së ujit: 200 ml.
- Kapaciteti maksimal i kanës, lëngjet: 450 ml.
- Mbrojtja: sistem nxehjeje me temperaturë të kontrolluar dhe siguresë.

Zgjidhja e problemeve

Ky kapitull përmbledh problemet më të shpeshta që mund të hasni me pajisjen. Nëse nuk mund ta zgjidhni problemin me informacionin e mëposhtëm, vizitoni www.philips.com/support për një listë të pyetjeve më të shpeshta ose kontaktoni me qendrën e kujdesit për klientin në shtetin tuaj.

Problemi	Shkaku i mundshëm	Zgjidhja
Pajisja nuk punon.	Pajisja është e pajisur me një siguresë. Nëse pjesët nuk janë montuar siç duhet në njësinë e motorit, pajisja nuk funksionon.	Montoni të gjitha pjesët siç duhet. Shihni kapitullin "Përdorimi i pajisjes".
Llamba e avullimit nuk ndizet.	Pajisja nuk është e futur në prizë. Kana nuk është vendosur siç duhet në njësinë e motorit.	Futni spinën në prizë. Vendoseni kanën siç duhet në njësinë e motorit.
	Dëshironi të nisni një proces të dytë avullimi pas përfundimit të procesit të mëparshëm.	Fikeni pajisjen dhe lëreni të ftohet për disa minuta para se të nisni një proces të dytë avullimi.

Problemi	Shkaku i mundshëm	Zgjidhja
Përbërësit nuk janë ngrohur plotësisht.	Copëzat në kanë janë shumë të mëdha, ka sasi të madhe ushqimi në kanë ose nuk e keni avulluar mjaftueshëm ushqimin.	Priteni ushqimin në copëza të vogla (2-3 cm), reduktoni sasinë e ushqimit në kanë ose zgjidhni një kohë më të gjatë avullimi (maks. 20 minuta). Kontrolloni broshurën e recetave dhe/ose tabelën në kapitullin "Përbërësit dhe kohët e avullimit" për t'u siguruar që keni zgjedhur kohën e duhur të avullimit për përbërësit që dëshironi të avulloni ose për recetën që dëshironi të përgatisni.
Pajisja nuk nxjerr avull.	Nuk keni hedhur ujë në pajisje.	Fikni pajisjen dhe hidhni sasinë e duhur të ujit në të.
	Nuk e keni vendosur kanën në njësinë e motorit në pozicionin e duhur.	Vendoseni kanën në pajisje në pozicionin e duhur (shihni seksionin "Avullimi" në kapitullin "Përdorimi i pajisjes").
Avullimi kërkon shumë kohë ose funksioni i avullimit nuk funksionon.	Ka shumë çmërs në depozitën e ujit.	Pastroni çmërsin nga depozita e ujit. Shihni kapitullin "Pastrimi dhe mirëmbajtja", seksioni "Pastrimi i çmërsit".
Nga vrima e mbushjes del avull.	Kapaku i vrimës së mbushjes nuk është mbyllur siç duhet.	Mbyllni siç duhet kapakun e vrimës së mbushjes ("klik").
	Dalja e avullit në njësinë e motorit është e bllokuar nga ushqimi ose çmërsi.	Pastroni daljen e avullit me një objekt me majë pa e dëmtuar gominën dhe ndiqni udhëzimet për pastrimin e çmërsit në të ardhmen. Shihni kapitullin "Pastrimi dhe mirëmbajtja", seksioni "Pastrimi i çmërsit".
	Vrima e avullit në kapak është e bllokuar.	Hiqni valvulën dhe pastroni vrimën e avullit në kapak siç duhet.
Llamba e avullimit ndizet sërish pas përfundimit të procesit të avullimit. Pas njëfarë kohe, pajisja bën sërish zhurmë.	Keni lënë kanën aksidentalisht në bazament për më shumë se 10 minuta pa e fikur pajisjen.	Fikeni pajisjen brenda 10 minutave pas përfundimit të procesit të avullimit dhe më pas përziejeni ushqimin ose hiqeni nga kana.

Problemi	Shkaku i mundshëm	Zgjidhja
Njësia e teheve ose njësia e motorit është bllokuar.	Ka sasi të madhe ushqimi në kanë.	Fikeni pajisjen dhe përpunoni një sasi më të vogël. Mos e mbushni kanën përtej buzës së sipërme të njësisë së gjelbër të teheve.
Njësia e motorit lëshon erë të pakëndshme gjatë herëve të para të përdorimit.	Kjo është normale.	Nëse pajisja vazhdon ta lëshojë këtë erë edhe pasi ta keni përdorur disa herë, kontrolloni nëse sasia dhe koha e përpunimit janë të sakta. Shihni kapitullin "Përbërësit dhe kohët e avullimit".
Pajisja vazhdon të lëshojë erë të pakëndshme pasi e kam përdorur disa herë.	Keni hedhur sasi të madhe ushqimi në kanë ose e keni lënë pajisjen që të përziejë për një kohë të gjatë.	Përpunoni sasi më të vogla dhe mos e lini pajisjen të përziejë për më shumë se 30 sekonda për rast.
Pajisja bën shumë zhurmë, lëshon një erë të pakëndshme, ndihet e nxehtë në prekje, nxjerr tym etj.	Ka sasi të madhe ushqimi në kanë.	Fikeni pajisjen dhe përpunoni një sasi më të vogël.
	Pajisja është lënë të punojë për një kohë të gjatë pa ndërprerje.	Mos e lini pajisjen të përziejë për më shumë se 30 sekonda për rast.
Nga kapaku i kanës ka rrjedhje.	Kapaku nuk është vendosur siç duhet në kanë.	Vendosni siç duhet kapakun në kanë. Shihni kapitullin "Përdorimi i pajisjes".
	Ka sasi të madhe ushqimi në kanë.	Fikeni pajisjen dhe përpunoni një sasi më të vogël.
Ka njolla në bardha në vrimën e mbushjes dhe/ose në kanë, sitë dhe kapak.	Në ato pjesë është krijuar çmërs.	Kjo është normale. Pastroni çmërsin periodikisht. Shihni kapitullin "Pastrimi dhe mirëmbajtja", seksioni "Pastrimi i çmërsit".

Problemi	Shkaku i mundshëm	Zgjidhja
Pajisja bën shumë zhurmë gjatë përzierjes.	Sita nuk është vendosur në kapakun e kanës ("klik").	Sigurohuni që sita të jetë vendosur në kapakun e kanës.
Uji në depozitën e ujit ka ngjyrë të pazakontë kur e nxirrni nga depozita ose kur hyn në kanë gjatë avullimit, ose uji në depozitën e ujit ka një erë të pakëndshme.	Grimca ushqimi kanë hyrë në depozitën e ujit gjatë përdorimit.	Pastroni depozitën e ujit sipas udhëzimeve në kapitullin "Pastrimi dhe mirëmbajtja", seksioni "Pastrimi i depozitës së ujit". Përdoreni pajisjen vetëm sipas udhëzimeve. Sigurohuni që të mos e tejmbushni depozitën e ujit (maks. 200 ml) dhe që të mos e tejmbushni kanën me ushqim (mos e mbushni kanën përtej buzës së sipërme të njësisë së gjelbër të teheve). Mos avulloni të njëjtët përbërës për më shumë se 20 minuta dhe mos e hidhni direkt në kanë ujin që do të përdoret për avullim. Gjithashtu, sigurohuni që valvula të jetë e fiksuar në kapak.
Nga depozita e ujit vjen një erë ushqimi të djegur.	Grimca ushqimi kanë hyrë në depozitën e ujit gjatë përdorimit dhe janë ngurtësuar në rezistencë.	Pastroni depozitën e ujit sipas udhëzimeve në kapitullin "Pastrimi dhe mirëmbajtja", seksioni "Pastrimi i depozitës së ujit". Përdoreni pajisjen vetëm sipas udhëzimeve. Sigurohuni që të mos e tejmbushni depozitën e ujit (maks. 200 ml) dhe që të mos e tejmbushni kanën me ushqim (mos e mbushni kanën përtej buzës së sipërme të njësisë së gjelbër të teheve). Mos avulloni të njëjtët përbërës për më shumë se 20 minuta dhe mos e hidhni direkt në kanë ujin që do të përdoret për avullim. Gjithashtu, sigurohuni që valvula të jetë e fiksuar në kapak.
Ka njolla të zeza në ushqimin e foshnjës ose uji në kanë ka ngjyrë të pazakontë.	Grimca ushqimi kanë hyrë në depozitën e ujit gjatë përdorimit dhe janë ngurtësuar në rezistencë. Kjo gjë bën që mbetjet e këtyre grimcave të ushqimit të futen në kanë gjatë avullimit.	Pastroni depozitën e ujit sipas udhëzimeve në kapitullin "Pastrimi dhe mirëmbajtja", seksioni "Pastrimi i depozitës së ujit". Përdoreni pajisjen vetëm sipas udhëzimeve. Sigurohuni që të mos e tejmbushni depozitën e ujit (maks. 200 ml) dhe që të mos e tejmbushni kanën me ushqim (mos e mbushni kanën përtej buzës së sipërme të njësisë së gjelbër të teheve). Mos avulloni të njëjtët përbërës për më shumë se 20 minuta dhe mos e hidhni direkt në kanë ujin që do të përdoret për avullim. Gjithashtu, sigurohuni që valvula të jetë e fiksuar në kapak.

